

RAPORT VJETOR 2025

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË KUJDESIT SHËNDETËSOR E SHOQËROR

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror (ASCKSHSH) është Institucion Publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr 637 dt.27.10.2021 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror”.

Misioni i ASCK

ASCKSHSH është strukturë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), e ngritur për të mbështetur Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në zbatimin e strategjisë së saj afatgjatë lidhur me sigurimin e cilësisë së produkteve/ përfitimeve të kujdesit shëndetësor me të gjitha elementet e tij nga të gjithë ofruesit (publikë ose privatë), me qëllim garantimin e kujdesit shëndetësor, shoqëror e cilësor dhe të bazuar në standarde, nëpërmjet edukimit dhe kontrollit të sigurisë së shërbimeve për strukturat dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe shoqëror.

1. Akreditimi Institucioneve Shëndetësore:

Gjatë periudhës **Janar -Dhjetor 2025**, **Spektori i Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore** në DSPA, ka vijuar ndjekjen e procesit të akreditimit sipas Planit Vjetor të Akreditimit për vitin 2025 dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Spektori ka **koordinuar** procesin me institucionet përgjegjëse si **Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, strukturat e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor** dhe ka **asistuar** institucionet e kujdesit shëndetësor në çdo hap të procesit, që nga vetëvlerësimi, **parapërgatitja** për procesin e aplikimit, **aplikimi** në platformën e-Albania, përgatitja për vlerësim të jashtëm, vlerësimi i jashtëm e më tej dorëzimi i **raporteve të vlerësimit e përgatitja e dosjeve** për çdo institucion në **Bordin e Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore**.

Paralelisht punës me dosjet fizike, procesi është ndjekur edhe në platformat online **AMS, SQDNE dhe SARA**.

Arritjet:

1. Finalizimi i procesit të akreditimit për **82 institucione të kujdesit shëndetësor**: 73 qendra shëndetësore, 2 spitale rajonale, 5 spitale bashkiake, 1 spital ditor publik, 1 spital jopublik.
2. Rinovimi i anëtarësimit institucional të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Kujdesin Shëndetësor e Shoqëror në **Shoqatën Ndërkombëtare të Cilësisë në Kujdesin Shëndetësor – ISQua**.
3. Hartimi i **Manualit të Vlerësuesve të Jashtëm në Procesin e Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore**, një dokument mjaft i rëndësishëm për rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të procesit.
4. Përditësimi i **databazës** me institucionet e kujdesit shëndetësor.
5. Bashkëpunimi dhe asistenca në ekspertizë në **grupet e punës** të MSHMS dhe projekteve të ndryshme.

Objektiva, sfida dhe problematika:

1. **Përditësimi i standardeve** të cilësisë për akreditim dhe hartimi i standardeve të reja për kategoritë që mungojnë.
2. **Harmonizimi i kriterëve të licencimit** me standardet bazë për akreditim.
3. Procesi i akreditimit të institucioneve jopublike dhe **përputhshmëria** me kategorinë e licencimit.
4. **Përditësimi i checklistës së inspektimit të ISHSH** me dokumentin e standardeve bazë për akreditim.
5. **Rishikimi i hapave të procesit të akreditimit** të institucioneve shëndetësore – ndryshime ligjore dhe nënligjore.
6. **Bashkërendimi i punës** mes Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor dhe Agjencisë në procesin e akreditimit, **prioritizimi dhe zbatimi i Planit Vjetor të Akreditimit** të Institucioneve Shëndetësore.
7. **Fuqizimi i kapaciteteve** të Agjencisë lidhur me trajnimet e burimeve njerëzore funksionale që ndjekin procesin, trajnimi i vlerësuesve të jashtëm dhe kordinatorëve të cilësisë dhe **fuqizimi i kapaciteteve lidhur me monitorimin në terren** të institucioneve të akredituara (*mjedise, burime njerëzore, mjete etj*).
8. **Interesi i ulët i institucioneve jopublike** për përfshirjen në procesin e akreditimit.
9. **Hartimi i kuadrit ligjor** për procesin e akreditimit të institucioneve të **kujdesit shoqëror**.

2. Standardet dhe Protokollet

Gjatë periudhës **janar - dhjetor 2025**, **Spektori i Standardeve dhe Protokolleve** në DSPA, ka vijuar ndjekjen e procesit të hartimit të **UPK dhe PPK** sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Arritjet:

1. U shqyrtuan nga Sektori i Standardeve dhe Protokolleve: **87 Protokolle dhe Udhëzues të Praktikës Klinike.**
2. U finalizua procesi për **25 Protokolle dhe Udhëzues të Praktikës Klinike** të cilat u miratuan me Urdhër të ministrit.
3. Është kryer rishikimi për **62 Protokolle dhe Udhëzues të Praktikës Klinike të QSUT**, për të cilat pritet përgjigje nga Shërbimet përkatëse.
4. Hartimi i një **draft-pakete për standardet e kujdesit ambulator sipas Joint Commision.**
5. Bashkëpunimi dhe asistenca në ekspertizë në **grupet e punës** së MSHMS dhe projekteve të ndryshme.
6. U shqyrtua “*Manuali i Psikologut në Kujdesin Shëndetësor Parësor*”, i hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Projekti ‘Shëndet për të gjithë’ (HAP). Pasi u konstatua përputhshmëria me standardet e këkuara u dërgua në MSHMS për miratim.
7. Pjesëmarrje në rishikimin e formulimeve nga Grupi i Punës i ngritur nga MSHMS për Standardet e Shërbimit Stomatologjik në Shqipëri, ku janë bërë sugjerimet përkatëse konform respektimit të kriterëve për njohjen e këtyre standardeve nga ASCK-ja.
8. Pjesëmarrje në Grupet e Punës të ngritur nga MSHMS për hartimin e standardeve për shërbimet e kujdesit shoqëror në vend.

Objektiva, sfida dhe problematika:

1. Zhvillimi i **kuadrit rregullator** për procesin e hartimit, rishikimit dhe miratimit të UPK, PPK dhe SOP, për të gjitha hapat e procesit.
2. Bashkëpunimi i ngushtë me shërbimet universitare;
3. **Vështiresi në marrjen e feedback**-ut nga një numër shërbimesh.
4. Rishikimi me **vonesë** i materialeve bazuar në sugjerimet e ASCK.
5. **Mungesa e ekspertizës** në këto shërbime për vlerësimin e impaktit ekonomik të UPK, PPK
6. **formimi dhe trajnimi i stafit përgjegjës** për ndjekjen e zbatimit të UPK, PPK, SOP
7. Pajisja e stafit te ASCK me **aplikacione** që bëjnë një verifikim të saktë të referencave shkencore të UPK, PPK, SOP të paraqitura nga shërbimet.
8. **Trajnimi** i stafit te ASCK me këto praktika.

3. Performanca

Nr.	Objektivi Specifik	Aktivitetet	Struktura/njësia përgjegjëse	Afati kohor
	Përshkruaj Objektivat e institucionit/njesisë përkatëse.	Përshkruaj aktivitetet/detyrat që do kryhen për arritjen e objektivit.	Shëno strukturën/njësinë/personin përgjegjës për kryerjen e aktivitetit/detyrës.	Shëno afatin kohor, datën deri kur do kryhet detyra/aktiviteti
1.	Matja e indikatorëve të performancës 2025 <ul style="list-style-type: none"> ▪ Matja e indikatorëve të performancës Spitalore në 40 spitale çdo vit ▪ (5 Universitare, 12 Rajonale 22 bashkiake), ku hidhen rezultatet dhe hartohen ▪ raportet mbi analizën dhe vlerësimin e indikatorëve. 	Trajnime për koordinatorët e cilësisë së spitaleve në lidhje me cilësinë dhe sigurinë dhe performancën <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mbledhja e indikatorëve në mënyrë korrekte dhe raportimi i sakte i tyre 	Drejtoria e performancës Shkurt maj 2026	Dergimi i raportit të indikatorëve të performancës në 15 maj 2026
2.	Trajnime për koordinatorët e cilësisë së spitaleve në lidhje me cilësinë dhe sigurinë dhe performancën	Përgatitja e prezantimeve mbi trajnimet on-line të anëtarëve të Komitetit të Përmirësimit të Cilësisë në spitale	Drejtoria e performancës	Gjate gjithë vitit
3.	Përgatitur për Drejtorinë e Performancës, informacione dhe materiale mbi mjetet, procedurat për Cilësinë, Sigurinë dhe performancën si dhe metodologjinë për vlerësimin e kënaqësisë së pacientit në Shërbimin Shëndetësor.	Model dokumentacioni për Cilësinë, Sigurinë dhe performancën si dhe metodologjinë për vlerësimin	Drejtoria e performancës	Gjate gjithë vitit

4	Hartimi i fleteve informative dhe marrjes se pelqimit te pacientit ne spital	Bashkepunim me sherbimin Spitalor Universitar	Drejtoria e performances	Gjate gjithë vitit
5	Monitorimi i ecurise se mbledhjes analizimit dhe raportimit te Treguesve te Performances Spitalore	Vizita ne spitalet, Spitali Rajonal i Tiranes “Shefqet Ndroqi”, Spitali Rajonal Elbasan, Spitali Rajonal Durres, Spitali Ditor Peqin, Spitali Bashkiak Kruje	Drejtoria e performances	Nentor -dhjetor 2025

Objektiva, sfida dhe problematika :

1. Arritjet: Matja e indikatoreve te performances 2024

- Matja e indikatoreve të performancës Spitalore në 39 spitale çdo vit
- (5 Universitare, 12 Rajonale 22 bashkiake), ku hidhen rezultatet dhe hartohen raportet mbi analizën dhe vlerësimin e indikatoreve.

hartohen raportet e në keto spitale dhe dërgohen në MSHMS

Jane derguar ne MSHMS 3 raportet indikatoreve të performancës Spitalore derguar ne maj te 2025

2. Matja e indikatoreve te performances 2025

- Matja e indikatoreve të performancës Spitalore në 39 spitale çdo vit
- (5 Universitare, 12 Rajonale 22 bashkiake), ku hidhen rezultatet dhe hartohen raportet mbi analizën dhe vlerësimin e indikatoreve.
- hartohen raportet e në keto spitale dhe dërgohen në MSHMS

Jane hartuar raportet dhe do dergohen ne MSHMS 3 raportet indikatoreve të performancës Spitalore ne maj 2026

3. Raportimi i Incidenteve dhe gabimeve mjekësore gjatë dhënies së shërbimit në kujdesin shëndetësor, duke e parë si mjet të rëndësishëm për përmirësimin e Cilësisë në shërbimin shëndetësor

4. Trajnim i koordinatorëve për cilësinë, sigurinë dhe të drejtat e pacientit në shërbimin Shëndetësor dhe shoqëror

5. Përgatitja për Drejtorinë, informacione dhe materiale mbi mjetet, procedurat dhe metodologjinë për Cilesinë, Sigurinë dhe të Drejtat e Pacientit në shërbimin Shëndetësor, performances spitalore.
6. **ASCKSHSH/ drejtoria e perormances** në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e QSUNT – së, Shefat e Shërbimeve, dhe Drejtorinë Spitalore në Ministrinë e Shëndetësisë, koordinon hap pas hapi procesin e punës për hartimin, formulimin dhe finalizimin e Fletës Informative dhe marrje Pëlqimi për pacientin dhe dërgon për miratim në MSHMS këto fletë informimi gjithesej 122 proceduar informimi miratuar me Urdher Ministri,

4. Akreditimi aktiviteteve dhe ofruesve.

Prioritetet dhe Arritjet e Sektorit te AEV për vitin 2025;

Rritja e cilesise se aktiviteteve te edukimit ne vazhdim permes shqyrtimit dhe vleresimit ne kohe dhe me cilesi, te aplikimeve per akreditim te aktiviteteve të edukimit ne vazhdim per profesionistet e shendetesise dhe profesionistet e Sherbimeve Sociale;

Pranimi i aplikimeve për akreditim dhe përsritje të aktiviteteve për profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe shoqëror vetëm online në platformën qeveritare e-albania.

- Bashkëpunimi ndërmjet sektorëve dhe me AKSHIN për testimin e shërbimeve në databazen e re.

- Numri i lartë i aplikimeve nga Insitucionet Shëndetësore Publike dhe jo Publike

Numuri i larte i akreditimeve te aktiviteteve te Edukimit ne Vazhdim (institucione Publike dhe jo publike , sociale dhe shendetesore)

Problematikat:

Veshtiresi nga ofruesit e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për përdorimin online të shërbimit « Aplikim për akreditim të aktiviteteve të edukimit në vazhdim ».

Implementimi i Sistemit dixhital dhe Realizimi i trajnimeve me stafin e ASCK dhe ofruesit e AEV në funksion të këtij shërbimi .

Viti	Nr . Aktiviteteve te EV te Akredituara	Nr. Aktiviteteve te Perseritura
Viti 2025	355	613

Objektivat :

Permiresimi i cilesine se aktiviteteve te edukimit ne vazhdim permes shqyrtimit dhe vleresimit ne kohe dhe me cilesi, ne respektim te percaktimeve te Dokumentit Rregullator te Akreditimit, te aplikimeve per akreditim te aktiviteteve të edukimit ne vazhdim per profesionistet e shendetesise dhe profesionistet e Sherbimeve Sociale;

Të zhvilloje dhe te perditesoje standardet dhe kriterete akreditimit te aktiviteteve te edukimit ne vazhdim permes ndryshimeve ne VKM 788, VKM 848 dhe VKM 440

Të ofroje mbeshtetje teknike per aktoret e perfshire ne zhvillimin e sistemit te edukimit ne vazhdim per permbushjen e kriterëve dhe standardeve te akreditimit te aktiviteteve te edukimit ne vazhdim.

Të ofroje mbeshtetje dhe ekspertizen e duhur per ofruesit e aktiviteteve te edukimit ne vazhdim

Të shqyrtoje dhe permylle konform standardeve te miratuara aplikimet per akreditim te aktiviteteve te edukimit ne vazhdim;

Përditësimi i dokumentit rregullator, i udhëzuesve dhe standardeve të edukimit në vazhdim.

Gjithashtu, vazhdon venia ne eficience te plote i sistemit Sara ne lidhje me aktivitetet e edukimit ne vazhdim ;

Berja pjese e ndryshimeve ligjore te VKM -ve te rishikuara si pjesë e udhëzuesve dhe standardeve të edukimit në vazhdim.

Pranimi i aplikimeve për akreditim të programeve dhe të ofruesve si dhe për përsëritje të AEV vetëm përmes portalit e-albania

Nxitje e shërbimit të kujdesit parësor për organizimin e grupeve të kolegëve si formë e edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë dhe të kujdesit shoqërorë

5.Sigurimi i Cilësisë dhe planifikimi programeve

Arritjet :

Në total, gjatë vitit 2025 janë monitoruar 160 aktivitete të edukimit në vazhdim. Për të njëjtin vit, janë akredituar gjithsej 715 aktivitete, nga të cilat 227 aktivitete të reja dhe 488 aktivitete përsëri tëse. Masa e monitorimit të realizuar përfaqëson 22.37% të totalit të aktivitetëve të akredituara,

duke tejkeluar ndjeshëm detyrimin minimal ligjor prej 10%, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Sa i përket shpërndarjes së aktiviteteve sipas organizatorëve, janë monitoruar 14 aktivitete të organizuara nga ofrues të akredituar, 10 aktivitete të organizuara nga Fondacioni Shëndetësor ABC, 1 aktivitet i organizuar nga Albanian University dhe 3 aktivitete të organizuara nga Swiss Foundation.

Nga totali i monitorimeve të realizuara, 104 monitorime i përkasin aktiviteteve të organizuara nga ofrues jo publikë, ndërsa 42 monitorime janë kryer për aktivitete të organizuara nga ofrues publikë.

Pas vlerësimit përfundimtar të aktiviteteve të edukimit në vazhdim, pas kryerjes së procesit të monitorimit për periudhën janar–dhjetor 2025, janë monitoruar në total 160 aktivitete të edukimit në vazhdim. Në përfundim të këtij procesi, rezultatet e vlerësimit paraqiten si më poshtë:

- Për 6 aktivitete të edukimit në vazhdim është vendosur reduktim i numrit të krediteve;
- Për 14 aktivitete të edukimit në vazhdim është vendosur anulimi i akreditimit;
- Për 17 aktivitete të edukimit në vazhdim është dhënë tërheqje vëmendjeje;
- Janë dhënë 4 paralajmërime për anulim aktiviteti;
- 119 aktivitete të edukimit në vazhdim kanë përmbushur plotësisht standardet e cilësisë së edukimit në vazhdim.

OFRUESIT E AKREDITUAR

Gjatë vitit 2025, në zbatim të VKM-së 440 datë 17.05.2017 “Për përcaktimin e standardeve, kriterëve dhe procedurave të procesit të akreditimit të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim është kryer monitorimi i ofruesve të akredituar.

Gjatë vitit 2025 përfundoi statusi si ofrues i akredituar afatgjatë për Universitetin e Mjekësisë Tiranë, Albanian University dhe SFI, për të cilët Komisioni përkatës kreu procesin e vlerësimit.

- Në përfundim, Universiteti i Mjekësisë Tiranë u vlerësua se përmbush kriteret dhe standardet për marrjen e statusit si ofrues i akredituar, me kusht depozitimin e listës së ekspertëve të pavarur të fushës dhe zbatimin e akteve nënligjore në fuqi. UMT autorizohet të akreditojë vetëm aktivitete të kategorisë “Konferenca”, me deri në 100 pjesëmarrës dhe pa sponsor, ndërsa për aktivitete që tejkalojnë këto kufizime do të aplikojë pranë ASCK. Aplikimet për aktivitetet e edukimit në vazhdim do të kryhen përmes shërbimit online në portalin “e-Albania”, ndërsa deri në funksionalizimin e plotë të këtij shërbimi, procedurat do të ndiqen sipas dispozitave ligjore në fuqi, me depozitimin e dokumentacionit në ASCK të paktën 7 ditë përpara zhvillimit të aktivitetit.
- Mos miratimin e statusit si “Ofrues i Akredituar”, për “ALBANIAN UNIVERSITY”, për shkak të mospërmbushjes së kriterëve dhe standardeve të përcaktuara. Refuzimi u bazua në faktin se subjekti ushtron veprimtari tregtare në fushën e pajisjeve mjekësore dhe produkteve estetike, duke u konsideruar palë me interes tregtar, çka përjashton mundësinë për të qenë ofrues i akredituar. Gjithashtu, nuk janë përmbushur kriteret sasiore lidhur me numrin e

aktiviteteve të zhvilluara, si dhe janë konstatuar parregullsi në aspektin cilësor gjatë monitorimeve të fundit.

- Fondacioni Shëndetësor ABC ka aplikuar për rinovimin e statusit si ofrues i akredituar afatgjatë, ndërsa procesi i vlerësimit nga grupi i punës është ende në vijim.
- Swiss Foundation (SFI) ka përfunduar afati 5-vjeçar si ofrues i akredituar, dhe deri më tani nuk ka dorëzuar aplikim për rifitim të statusit.

Objektivat, sfidat dhe problematika:

Rritja e kapaciteteve monitoruese të stafit:

Përmirësimi i aftësive cilësore të stafit për monitorimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim (EV), me fokus të veçantë në aktivitetet e edukimit në distancë.

Ripërcaktimi i rolit të koordinatorëve lokalë dhe personave të kontaktit:

Rishikimi i detyrave funksionale të monitoruesve lokalë dhe përmirësimi i proceseve të tyre për të siguruar një monitorim më efektiv dhe të standardizuar.

Organizimi i aktiviteteve edukative për standardet e monitorimit:

Realizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve informuese mbi zbatueshmërinë e standardeve të cilësisë në monitorimin e aktiviteteve të EV.

Monitorimi i aktiviteteve të organizuara nga stafi i ASCK-së:

Vlerësimi i këtyre aktiviteteve përmes formularëve të vlerësimit nga pjesëmarrësit, dhe përfshirja e rezultateve në raportin përfundimtar të monitorimit dhe akreditimit të aktiviteteve.

Bashkëpunimi dhe informimi i ofruesve të akredituar:

Hartimi i një plani takimesh me ofruesit e akredituar për informimin mbi rekomandimet dhe udhëzimet e ASCK-së, si dhe mbështetja në implementimin e tyre.

Forcimi i mekanizmave të konsultimit:

Vlerësimi i angazhimit të ofruesve të EV dhe profesionistëve në kuadër të sigurimit të cilësisë, duke garantuar ndikim pozitiv në palët e interesuara.

Monitorimi i ofruesve të akredituar:

Garantimi i zbatimit të kriterëve dhe standardeve të akreditimit gjatë zhvillimit të aktiviteteve, për të siguruar cilësi të qëndrueshme dhe përputhshmëri me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi.

6. Certifikimi i profesionistëve

Gjate vitit 2025 periudha **01.01.2025-31.12.2025** në Rregjistrin e Profesionistëve numërohen rreth **2775 profesionistë** te regjistruar . Në tabelën më poshtë regjistrimet ne vitin 2025

Profesioni	2025
Mjek	354
Stomatolog	234
Farmaciste	174
Infermiere	1865
Psikolog	116
Punonjes social	106
Total	2775

Më poshtë një tabelë tregon ecurinë e certifikimit të profesionistëve per vitin 2025.

Pajisur me vertetim per te pare gjendjen e krediteve / Certifikuar Viti 2025	mjek	1159
	stomatolog	602
	farmacist	426
	Nd/farmaciste	21
	infermiere	970
	Total	3178

Më poshtë nje pasqyrë e regjistrimeve në kartelat e profesionistëve gjate vitit 2025.

Kreditet e regjistruara në kartelat e profesionistëve	Viti 2025
	510.426

Arritjet :

- Pranimi i aplikimeve per regjistrim i profesionisteve te shendetesise dhe kujdesit shoqror ne programin e certifikimit vetem online ne platformen qeveritare e-albania 2025 rreth 4718
- Pranimi i aplikimeve per statusin e certifikimit te profesionisteve te shendetesise dhe kujdesit shoqror vetem online ne platformen qeveritare e-albania 2025 rreth 10.253
- Pranimi i aplikimeve per pajisjen me vertetim per kredite te profesionisteve te shendetesise dhe kujdesit shoqror vetem online ne platformen qeveritare e-albania 2025 rreth 15.292
- Bashkepunimi ndermjet sektoreve dhe me AKSHIN per testimin, permiresim te sherbimeve ne databazen e re.
- Numri i lartë i aplikimeve nga profesionistet e shendetesise dhe kujdesit shoqror
- U miratuan ndryshimet e propozuara per Vkm 789

Objektivat :

- Regjistrimi ne kohe i profesionisteve te shendetesise dhe kujdesit shoqror ne programin e certifikimit
- Përditësimi i të dhënave të profesionistëve (NID, atësi dhe cikël individual)
- Rritje e numrit të aplikimeve për regjistrimin e profesionisteve
- Rritje e numrit të aplikimeve për Statusin e certifikimit
- Rritje e numrit të aplikimeve për pajisjen me vertetim per kredite.
- Pranimi i aplikimeve për regjistrim te profesionisteve , te statusit te certifikimit si dhe per pajisjen me vertetim per kredite vetëm përmes portalit e-albania
- Perpunimin e te dhenave dhe nxjerrjen e raporteve periodike dhe vjetore per efekt statistikash
- Krijimi i raporteve periodike ose vjetore per nxjerrjen e te dhenave (regjistrime, certifikime, regjistrime kreditesh) nga sistemi.